

Titulli	Vlerësim i nivelit të ndotjes akustike
Institucioni	Instituti i Shëndetit Publik Departamenti i Vlerësimit dhe Trajtimit të Risqeve të Shëndetit Publik
Përshkrimi	Çdo institucion shtetëror apo privat, që ka interes apo ndeshet me problematika në fushën e ndotjes akustike mund të paraqitet në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP) për monitorimin dhe vlerësimin e saj. Në këto kushte ISHP, referuar Ligjit Nr.9774, dt.12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, neni 7, ku përcaktohet si njësi bazë e referencës , si dhe në bazë të Udhëzimit Nr.5, datë 26.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat për pajisjen me leje të thjeshtë mjedisore të veprimtarive që lëshojnë zhurma në mjedis” pika3/d, ofron ekspertiza të vlerësimit të nivelit të ndotjes akustike.
Dokumentacioni i nevojshëm	Subjekti që kërkon matje të ndotjes akustike, duhet të paraqesë një kërkesë-përshkrim në institucionet shtetërore si: Inspektorati Shtetëror i Shëndetësisë (ISHSH), Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit (ISHMPUT), Agjencia Kombëtare e Mjedisit AKM) dhe Pushteti Vendor, të cilat ia adresojnë Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH). Në rastet kur subjekti kërkon matje të nivelit të ndotjes akustike, për tu pajisur me Leje Mjedisore, paraqet kërkesën pranë AKM, e cila ia adreson ISHP, bazuar në Udhëzimit Nr.5, datë 26.11.2010. Subjektet duhet të paraqesin dhe çertifikatën e rregjistrimit në QKB (NIPT).
Hapat e procedurës	Përfaqësuesi i subjektit duhet të paraqesë pranë ISHP, shkresën përkatëse ku duhet të jetë e shkruar qartë emri i subjektit që bën kërkesën me adresë të saktë, qëllimin për të cilin kërkon të bëhet matja, adresa e saktë e vendit ku do të behet matja dhe një numër telefoni, kontakti apo adresë e-mail. Kjo kërkesë dorëzohet pranë sekretarisë së Institutit të Shëndetit Publik e cila më pas i kalon titullarit të Institucionit për vlerësim (miratim), e më pas protokollohet. Kërkesa, pasi firmoset nga titullari i Institucionit, i adresohet për zbatim titullarit të Departamentit të Vlerësimit dhe Trajtimit të Risqevë të Shëndetit Publik., i cili më pas, e dërgon në Sektorin e Fizikës Sanitare, për fillimin e procedurave. Përgjegjësi i sektorit cakton specialistët teknike të cilët planifikojnë dhe kryejnë matjet. Pas kryerjes së kësaj procedure, raporti i matjeve firmoset nga personat përgjegjës, titullari i Departamentit dhe Institucionit, protokollohet në sekretarinë e ISHP-së, dhe subjekti i interesuar merr një kopje zyrtare të raportit të hartuar, pasi ka kryer dhe pagesën financiare të matjeve.
Kushti i vendimit	Ky lloj shërbimi ofrohet cdo ditë të javës nga e Hëna – Premte dhe procedura e matjeve/vlerësimit varet nga situata konkrete e saj.
Periudha e vlefshmërisë	Vlerësimi i matjeve të kryera nga specialistët e Sektorit të Fizikës Sanitare, vlen për sa kohë nuk ka ndryshuar kapaciteti i burimit të zhurmës dhe konfiguracioni i mjedisit brenda tij.
Shpenzimet	Vlera minimale është 10 000 lekë për një ekspertizë.
Adresa URL	ishp.gov.al
Subjekti	Shëndeti dhe mirëqënia
Profili	Subjekt shtetëror dhe privat

Zyrë	Departamenti i Vlerësimit dhe Trajtimit të Risqeve të Shëndetit Publik, Sektori i Fizikës Sanitare	
Sheshi/ Rruga	Rruga Aleksandër Moisiu	Numri i rrugës 80
		Kodi postar
Qyteti	Tiranë	
Orari i hapjes	Të Hënë - të Enjtë, nga ora 8:00 - 16:30 dhe të Premte nga ora 8:00 - 14:00	
Numri i telefonit	+355 42374756	
Adresa e email-it	ishp@shendetesia.gov.al	